



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

**PËR DREJTOR TË PËRGJITHSHËM
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË (ASCAL)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 18, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, pika 6 nenit 14, të ligjit, nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, pikës 7, të vendimit nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 137, datë 26.09.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall thirrjen për:

- **Drejtor të Përgjithshëm të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.**

I. KËRKESAT E PËRGJITHSHME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
6. Të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

II. KËRKESAT E POSAÇME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të zotërojë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
2. Të ketë të eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet në institucione që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit të lartë, duke përfshirë edhe eksperiencë në nivele të larta drejtuese.
3. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbëjnë avantazh (dëshmi, certifikata).

III. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi
2. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
3. Dokumentin e gradës shkencore “Doktor”. Grada shkencore “Doktor” e fituar jashtë vendit duhet të shoqërohet me dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë.
4. Diplomat e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga institucioni përgjegjës në Republikën e Shqipërisë.
5. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
6. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
7. Fotokopje e kartës së identitetit;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
11. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
12. Vërtetim nga gjykata që nuk ka proces penal.

Të gjitha dokumentat që janë fotokopje duhet të dorëzohen të njësuar me origjinalin. Shprehja e interesit dhe dokumentacioni i sipërcituar duhet të dorëzohen nëpërmjet shërbimit postar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në adresën: “Rruga e Durrësit”, Nr. 23, AL 1001, Tiranë, **deri në datën 11.08.2025.**

IV.PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË:

1. Përgjigjet për funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në përputhje me Kodin e Cilësisë. Bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë dhe mban marrëdhënie të vazhdueshme me to.
2. Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin për përgatitjen e standarteve shtetërore të cilësisë dhe përditësimin në vijim të tyre si pjesë e Kodit të Cilësisë.
3. I propozon ministrit përgjegjës për arsimin ndryshimin e bazës ligjore në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.
4. Bashkërendon aktivitetin e saj me ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e saj të varësisë, në shërbim të politikave që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë, për vlerësimin e kërimit shkencor, financimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe shkëmbimin e të dhënave në fushën e arsimit të lartë.
5. Çdo detyrë tjetër sipas objektit të veprimtarisë së ASCAL dhe përgjegjësive të tij të përcaktuara në vendimin nr. 109, atë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për

përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar.

V. VERIFIKIMI DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E LISTËS PËRFUNDIMTARE

Në përfundim të afatit të aplikimit, MAS pas shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve do të njoftojë në rrugë elektronike, brenda 2 (dy) ditëve pune kandidatët që plotësojnë/nuk plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme.